

PROCES-VERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje me qira Kamionë për Terminalin e Kontenierëve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Marrje me qera e pajisjeve lëvizëse të tokës me operator 45520000-8

Afati i lëvrimin do jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

VLERA E FONDIT LIMIT për procedurën e prokurimit:

“Marrje Mjetesh me qera Kamione për nevojat e Terminalit të Kontenierëve” me fond limit 112,201,650 (Njëqind e dymbëdhjetë miliona e dyqind e njëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Autoriteti Portual Durrës**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 9, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe shtojcës 10 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku mesatarja e xhiros vjetore, të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme lidhet me natyrën e kontratës e cila përfshin

- Disponueshmeri të vazhdueshme të mjeteve
- Furnizim me karburant
- Mirembajtje full service
- Dhe perballim të kostove operative gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit.

Është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Udhëzimit të përgjithshëm Nr. 26 datë 08.09.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

Me Kontrata te ngjashme do te konsiderohen:

Sherbime transporti nepermjet mjeteve te llojit kamion.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2.Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi të forcës punëtore si me poshte:

1. Operator Mjeti TRUCK (TT) – 13 (Trembedhjetë) punonjes, i cili është përgjegjës për drejtimin e kamionit për transportin e sigurt dhe në kohe të konteinereve në perputhje me rregullat dhe udhëzimet perkatese. Përmeshja e këtij kushti duhet të dëshmohet përmes
 - CV-së së stafit, dëshmisë së punësimit sipas legjislacionit,
 - Dëshmi shoferi perkatese për kamion+rimorkio, (kategoria CE)

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentim për numrin e stafit

Numri minimal i stafit është përcaktuar bazuar në analizën e volumit të operimeve në terminal, kompleksitetin e proceseve të ngarkim-shkarkimit dhe nevojën për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit në disa fronte pune njëkohësisht.

Në këtë kuadër, është vlerësuar se për përballimin e fluksit mesatar dhe maksimal të operimeve, kërkohet një strukturë minimale stafi që siguron:

- zëvendësimin në rast mungese apo defekti;
- respektimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë së shërbimit.
- Për rrjedhojë, kërkesa për numrin e stafit konsiderohet proporcionale me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Shërbimi i kërkuar kërkon realizimin e operacioneve që përfshijnë ngarkim-shkarkim konteinerësh nga anija, zhvendosje-perpunim brenda terminalit, perpunim konteineresh për

terminalin e konteinereve (auto), perpunim konteinersh per llogari te organeve ligjzbatuese (dogane/polici, etj).

Keto sherbime do te kerkonin me patjeter nga OE, perdorimin e mjeteve operacionale nga punonjes te mjaftueshem dhe te kualifikuar me qellim realizimin ne kohe dhe me cilesi te sherbimit dhe si rrjedhoje te kontrates.

ARGUMENTIMI PER NUMRIN E MJETEVE QE NEVOJITEN DHE STAFIN MINIMAL QE DUHET TE KETE OPERATORI

Perllogaritja e mjeteve qe nevojiten te merren me qera

Flota aktuale e mjeteve ne dispozicion eshte si me poshte:

Mjete TT – 4 njesi (Nga flota egzistuese e mjeteve TT, vetem 1-2 mjete rezultojne me disponueshmeri te qendrueshme operacionale, ndersa pjesa tjeter paraqet nderprerje te shpeshta per shkak te nevojave per mirembajtje dhe avari teknike).

Koke kamioni (TT), te nevojshem duke konsideruar produktivitetin e dy vincave MHC:

Distanca maksimale e perpunimit = 1 km

Koha mesatare per nje cikël ngarkim-shkarkimi = 11 min

Produktiviteti per TT = 5-6 levizje/ore

Produktiviteti i vincave = 40-50 levizje ne ore

Numri i kamioneve te nevojshem = $45/5.5 = 8.2$

Numri i kamioneve te nevojshem ne total, perfshire vonesat, planifikimin, trafiku anijeve, trafiku i terminalit, etj (20%-30%) = **11.25**

Numri i kamionave disponibel (Flota e APD ne gjendje funksionale) = 2

Diferenca (mjete te munguara, koke kamioni) = **9 per 6 mujorin e pare**

Diferenca (mjete te munguara, koke kamioni) = **9-4 (qe do blihen)=5 per 6 mujorin e dyte**

Numri aktual i rimorkiove qe disponon A.P.D = 6

Diferenca (mjete te munguara, rimorkio) = **2**

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet si më poshtë:

Marrje me qera mjetesh Kamione per nevojat e Terminalit te Konteinereve

Nr.	Mjeti (Tipi)	Njesia	Sasia
1	Koke Kamioni (terheqes) per transport te brendshem per konteniere minimumi 60 ton	cope	9
2	Rimorkio Kamioni e dedikuar per transport konteineresh minimumi 60 ton	cope	2

Perlllogaritja e numrit minimal te shofereve qe nevojitet te kete Operatori ofertues

Gjithsej Autoriteti Portual Durres ka ne organike 24 shofere kamioni.

Duke ju referuar numrit te Kamionave qe nevojiten (9 cope sipas analizes me siper) dhe nevojës per perdorim te tyre mesatarisht me 2.5 turne, atehere mund te perlllogarisim qe minimalisht nje operator ofertues duhet te kete te pakten 13 punonjes shofere kamioni ($9 \times 2.5 \text{ turne} \times 1.3 = 29.25$ punonjes) (1.3 eshte koeficienti i zevendesimit per ditet e pushimit, lejet, festat etj). Autoriteti Portual ka ne organike 24 punonjes shofere kamioni

Autoriteti Portual ka 2 kamiona funksionale dhe per keta 2 kamiona funksionale nevojiten gjithsej:
 $2 \text{ kamiona} \times 3 \text{ turne} \times 1.3 \text{ koeficienti} = 8 \text{ shofere kamioni}$

$24 \text{ shofere gjithsej} - 8 \text{ shofere} = 16 \text{ shofere nga te portit mund te perdoren per mjetet me qera}$

$29 - 16 = 13 \text{ shofere}$

Numri minimal i shofereve eshte perlllogaritur duke marre ne konsiderate organizimin e punes me turne, nevojën per zevendesime ne raste mungesash, si dhe garantimin e vazhdimesise se sherbimit gjate gjithe periudhes operative.

Pra operatori ofertues duhet te kete minimalisht 13 shofere kamioni

Specifikime minimale teknike për Koke Kamioni (TT)

- Mjet Terheqes (standart), I perlllogaritur me fuqine perkatese per terheqjen e rimorkiove per konteniere minimumi 60 ton per transport te brendshem.

Specifikime minimale teknike për Rimorkio

- Rimorkio Kamioni (e dedikuar per konteniere) per transport konteineresh minimumi 60 ton

Dokumentacioni i nevojshem:

- Për mjetet Kokë traileri për Kontenierët dhe Rimorkio në pronësi duhet të paraqitet:
 - ✓ dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë);
 - ✓ leje qarkullimi;
 - ✓ çertifikate e kontrollit teknik;
 - ✓ siguracion mjeti, (i vlefshëm);
- Për mjetet Kokë traileri për Kontenierët dhe Rimorkio me qera duhet të paraqitet:
 - ✓ kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
 - ✓ dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
 - ✓ leje qarkullimi;
 - ✓ çertifikaten e kontrollit teknik,
 - ✓ siguracion mjeti (i vlefshëm);

- Për mjetet që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar.

Argumentim:

Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar kryerjes së shërbimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së shërbimit, termave të referencës. Për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Argumentimi mbi Marrëveshjen Kuadër:

1. Marrëveshja kuadër do të lidhet me një operator ekonomik, pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: lista e shërbimeve, termat e references,

2. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE, duke parë edhe natyrën e shërbimeve dhe përgjigjen e nevojave imediate të AK kjo mund t'i shkaktojë kosto shtesë, pasiguri, dhe vështirësi autoritetit kontraktor, si p.sh. vonesa dhe jo cilësi në ofrimin e shërbimeve.

Arsyetimi për mos ndarjen në lote.

Marrja me qira e kamionave ishte parashikuar në një procedure të vetme pa u ndare në lote pasi behet fjalë vetëm për vetëm një tipologji shërbimi. Për më tepër procedura ka qenë e parashikuar fillimisht për tu zhvilluar si :Marrje me qera kamiona dhe reachstackera dhe është arsyetuar duke proceduar me ndarjen e tyre në dy procedura të ndryshme për marrjen me qera të kamionave dhe marrjen me qera të reachstackera.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.

- **Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht, si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publike, t’i certifikojnë ato me vulën “Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.**

Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.